

EC

MA NDREYSHË

RAPORT MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT NË NIVEL KOMUNAL – 2023



Maj, 2024



RAPORT MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT NË NIVEL KOMUNAL – 2023

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren,
Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 No.7

www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org

029 222 771 / 038 224 967

Raporti “MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT NË NIVEL KOMUNAL – 2023” është realizuar nga EC Ma Ndryshe, i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, (Sida) përmes Programit të saj “Human Rightivism” që implementohet nga Community Development Fund – CDF.

Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtarë të donatorëve.



Maj, 2024

PËRMBAJTJA:

HYRJE	4
GJETJET E RAPORTIT	6
1 KOMUNA E PRIZRENIT	6
2 KOMUNA E PRISHTINËS	11
3 KOMUNA E PEJËS	16
4 KOMUNA E MITROVICËS JUGORE	21
5 KOMUNA E GJILANIT	26
6 KOMUNA E FERIZAJIT	31
7 KOMUNA E GJAKOVËS	36
8 KOMUNA E RAHOVECIT	41
9 KOMUNA E MALISHEVËS	45
10 KOMUNA E SUHAREKËS	49
11 KOMUNA E DRAGASHIT	53
12 KOMUNA E MAMUSHËS	56
PËRFUNDIME	58
REKOMANDIME	60

HYRJE

Ky raport është një përpjekje e strukturuar e shoqërisë civile për të adresuar e trajtuar përgjegjësitë e organeve kompetente të Qeverisë Lokale, përkatësisht përgjegjësitë e Komunave përgjatë vitit 2023 karshi aspekteve mjedisore që rregullohen me kornizën ligjore të vendit.

Organet përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit janë të rregulluara në forma të ndryshme në Komunitat e Kosovës. Disa nga komunitat kanë drejtori të dedikuara për mbrojtjen e mjedisit, ndërsa disa kanë sektore në kuadër të drejtorive për planifikim apo zyrtarë përgjegjës për çështje mjedisore.

Metodologjia e ndjekur nga EC Ma Ndryshe për përpilimin e këtij raporti merr në konsideratë **12 ligje** që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, si:

- **Ligji nr.03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit**
- **Ligji nr.03/L-233 për mbrojtjen e natyrës**
- **Ligji nr.03/L-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja**
- **Ligji nr.2003_3 për pyjet e Kosovës**
- **Ligji nr.04/L-147 për ujërat e Kosovës**
- **Ligji nr.04/L-060 për mbeturina**
- **Ligji nr.06/L-035 për veprimtaritë hidrometeorologjike**
- **Ligji nr.03/L-119 për produktet biocide dhe shtojcat**
- **Ligji nr.02/L-53 për gjuetinë**
- **Ligji nr.04/L-197 për kimikate**
- **Ligji nr.04/L-174 për planifikimin hapësinor**
- **Ligji nr.04/L-175 për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit.**

Mbi këtë bazë përmbajtja e këtij raporti tenton që të mbulojë aspektet kryesore që legjislacioni në fuqi adreson, si:

- Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor
- Korniza ligjore
- Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit
- Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor
- Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave
- Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike
- Licencimi dhe lejet mjedisore

Gjetjet e këtij raporti në **12 komuna të Kosovës** kanë identifikuar mangësitë në sektorin e mjedisit, që kërkojnë vëmendje më të shtuar nga autoritetet komunale, me qëllim të përmirësimit të procesit të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor, derisa në Komunat që janë monitoruar edhe në vitet paraprake është shqyrtuar po ashtu nëse ka pasur përmirësime gjatë vitit 2023 në këto aspekte.

Në fund të raportit janë adresuar disa rekomandime me qëllim të përmirësimeve dhe plotësimeve në proceset e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor, drejt arritjes së rezultateve më të qëndrueshme në sektorin e mjedisit dhe mbrojtjen më efikase të resurseve natyrore.



GJETJET E RAPORTIT KOMUNA E PRIZRENIT

1

Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Në Komunën e Prizrenit organi përgjegjës për planifikim dhe menaxhim mjedisor është Sektori i Mjedisit dhe i Menaxhimit të Mbeturinave që funksionon në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Stafi i DSHP-së, përbëhet prej gjithsej **14 punonjësve**, prej të cilëve **5 zyrtarë** janë të angazhuar në Sektorin e Mjedisit dhe të Menaxhimit të Mbeturinave dhe nuk ka pasur ndonjë përmirësim gjatë vitit 2023.

Ky sektor përbëhet prej udhëheqësit të sektorit, bashkëpunëtorit profesional për mjedis, përgjegjëses për menaxhimin e mbeturinave, inspektorit për mjedis dhe shërbyesit në sportel (arkëtarit).

Sipas zyrtarëve numri i angazhuar i shërbyesve civil është i mjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore. Sipas tyre shërbyesit civil në SMMM kanë profilet e nevojshme profesionale për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore.

SMMM ka bërë të ditur se gjatë vitit 2023 nuk ka pas ndonjë përmirësim ngase për punonjësit e këtij sektori nuk janë organizuar trajnime rreth kornizës ligjore, as nga niveli qendror, e as nga komuna apo ndonjë organizatë tjetër. Gjithashtu në vitin 2023 nuk është organizuar asnjë trajnim rreth çështjeve mjedisore për stafin e SMMM, as nga niveli qendror, e as nga komuna apo ndonjë organizatë tjetër.

Stafi i SMMM gjatë vitit 2023 nuk ka shfrytëzuar ndonjë udhëzues profesional për planifikimin dhe menaxhimin e çështjeve mjedisore, por gjatë kryerjes së detyrave kryesisht është fokusuar në legjislacionin në fuqi dhe dokumentet strategjike.

2

Korniza ligjore

Metodologjia e EC-it, merr në konsideratë **12 ligje** që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, të cekura më lartë.

Komuna e Prizrenit, përkatësisht SMMM ka raportuar se mbështetet në këto dokumente ligjore:

- 1 **Plani Lokal i Veprimit Mjedisor 2014-2018**
- 2 **Rregullorja Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave Nr. 01/011-31308, 19 shtator 2015**
- 3 **Plani Pesëvjeçar i Menaxhimit të Mbeturinave të Ngurta 2013-2018, shtator 2013**
- 4 **Plani Master për Menaxhimin e Mbeturinave 2014-2023, Nr. 01/011-161014, 03 shtator 2015**
- 5 **Ligji Nr. 02/L-30 për Menaxhimin e Mbeturinave**
- 6 **Ligji Nr. 03/L-024 - Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis**
- 7 **Ligji Nr. 03/L-25 për Mbrojtjen e Mjedisit**
- 8 **Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës**
- 9 **Ligji Nr. 03/L-160 për mbrojtjen e ajrit**
- 10 **Ligji Nr.04/ L-147 për ujërat e Kosovës**
- 11 **Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma**

Zyrtarët e SMMM të Komunës së Prizrenit kanë shprehur bindjen se korniza ligjore mjedisore nuk është e konsoliduar. Por nuk kanë listuar mangësitë kryesore ligjore të cilat i hasin gjatë punës së përditshme. Sipas tyre, Plani Lokal i Veprimit Mjedisor është hartuar për periudhën 2014-2018 dhe se edhe këtë vit nuk ka pasur ndonjë iniciativë për hartimin e një plani të ri për periudhën në vazhdim.

Ndërsa njohuritë e stafit të këtij sektori rreth kornizës respektive ligjore i kanë notuar me **4**, nga **1/aspak** deri **5/shkëlqyeshëm**.

3

Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit

Sikurse një vit më parë, rrjedha e ciklit të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor nuk shquhet për qasje të strukturuar dhe të organizuar. Hartimi i politikave mjedisore kërkon dinamizëm me qëllim që ato ti përgjigjen nevojave të kohës. Plani Lokal i Veprimit në Mjedis ka skaduar në vitin 2018 dhe nuk është hartuar plani i ri.

Programet mjedisore sipas SMMM edhe përgjatë vitit 2023 kanë përfshirë fushën Vetëdijesimit ku janë shënuar ditë të ndryshme mjedisore dhe janë realizuar anketa me qytetarë, po ashtu është punuar edhe drejt Eliminimit të Pikave të Zeza, Minimizim e Mbeturinave ku janë shpërndarë komposter dhe është organizuar kampanjë për rëndësinë e përdorimit të komposterëve, Edukimin në Shkolla, por përsëri edhe këtë vit nuk janë prezantuar raportet e zbatimit si dhe rezultatet e arritura.

SMMM ka raportuar se projektet e kontraktuara janë menaxhimi i mbeturinave, mirëmbajtja e rrugëve, shesheve dhe hapësirave të gjelbra dhe shtratit të gjatë sezonit dimëror dhe veror, dhe shtratit të Lumbardhit, hartimi i disa projekteve infrastrukturore, etj.

Sipas zyrtarëve, hartimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit janë në përputhje me strategjitë mjedisore në fuqi. Planet e nivelit lokal për menaxhimin mjedisor në vitin 2023 kanë vazhduar që të jenë në nivel modest.

4

Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor

Komuna e Prizrenit ka raportuar se inspektimi i zbatimit të kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit dhe hartimi i raporteve përkatëse realizohet, por nuk janë ofruar hollësi të mëtutjeshme respektivisht raporte të tilla.

Përsëri edhe këtë vit gjendja e deponive të mbeturinave sipas zyrtarëve nuk monitorohet në tërësi, por vetëm pjesërisht, ndërkohë që nuk janë zhvilluar vlerësime të ndikimit të deponive ekzistuese të mbeturinave në mjedis.

Sa i përket çrregullimeve mjedisore, përgjegjësia i është adresuar Drejtorisë së Inspektorateve, ku është raportuar se ka raste të ndryshme të identifikimit të çrregullimeve mjedisore të cilat janë adresuar tek organet kompetente komunale dhe MMPHI.

Kjo drejtori ka raportuar se gjatë vitit 2023 ka pasur vetëm **një inspektor mjedisor** dhe se janë realizuar:

Mbikëqyrje inspektimi me procesverbal

124

Asistime në inspektime

124

Vendime

18

Rekomandime, urdhëresa dhe vërejtje

1

Inicime në Gjykata

18

Ndërsa më tutje kanë theksuar se kanë pasur inspektime të rregullta me inspektorët e KPMM-së dhe inspektorët e MMPHI-se, tek guroret, ku në raste të caktuara janë marrë masa ndëshkuese dhe është ndërprerë veprimtaria, derisa operatori ekonomik të pajiset me dokumentin e kërkuar. Gjithashtu edhe personat fizik që kanë nxjerrë rërë nga Drini, janë ndaluar dhe konfiskuar e më pas edhe gjobitur nga inspektorët të KPMM-së.

Po ashtu, Komuna e Prizrenit ka themeluar vendgjuetitë, por ato nuk janë funksionalizuar ende, dhe si pasojë nuk ka pas përmirësime gjatë vitit 2023.

5 Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave

Komuna e Prizrenit nuk ka raportuar për ndonjë përmirësim të ndjeshëm sa i përket grumbullimit dhe menaxhimit të dhënave mjedisore, përfshirë ajrin, ujërat e tokën.

Komuna e Prizrenit nuk ka sistem të monitorimit të dheut, e as sistem të monitorimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Ndërsa parashikimi dhe paralajmërimi i hershëm i vërshimeve dhe thatësirave, sipas zyrtarëve komunalë bëhet nga niveli qendror respektivisht AME, dhe se në raste emergjente intervenohet nga organet përkatëse.

Administrata lokale as në vitin 2023 nuk ka ndërtuar sistem të menaxhimit të dhënave mjedisore. Sipas zyrtarëve komunalë, DSHP-ja nuk ka kapacitete të nevojshme teknike e as njerëzore për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore, pasi që në SMMM siç është cekur më lartë janë të angazhuar vetëm **5 punonjës**.

SMMM mirëmban sistemin e të dhënave sa i përket sasisë së mbeturinave komunale.

6 Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike

Zyrtarët përgjegjës të Komunës së Prizrenit bashkëpunimin dhe koordinimin me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore e kanë vlerësuar si të pamjaftueshëm. Ngjashëm është vlerësuar edhe bashkëpunimi dhe koordinimi me nivelin qendror sa i përket hartimit të strategjive mjedisore. Në vitin 2023 nuk ka pasur ndonjë përmirësim në këtë drejtim.

Niveli i bashkëpunimit me organizatat joqeveritare sa i përket zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme është në nivel të kënaqshëm, ku përfshihen aktivitete të ndryshme për promovimin e mbrojtjes së mjedisit. Pjesëmarrja publike edhe në vitin 2023 nuk ka qenë në nivelin e dëshiruar sa i përket aspekteve që kanë të bëjnë me mjedisin.

7 Licencimi dhe lejet mjedisore

Raportimi i Komunës mbi numrin e licencave dhe lejeve mjedisore aktive, nuk është përmirësuar ngase është ofruar vetëm numri i lejeve mjedisore të lëshuar nga DSHP-ja për vitin 2023.

Pra sipas të dhënave të paraqitura nga Komuna në vitin 2023 janë lëshuar gjithsejtë **86 leje mjedisore**. Sa i përket lejeve ujore nuk janë ofruar të dhëna nga SMMM.



GJETJET E RAPORTIT KOMUNA E PRISHTINËS

1

Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Në Komunën e Prishtinës organe përgjegjëse për planifikim dhe menaxhim mjedisor janë Sektori për Menaxhimin e Mbeturisë, Ambientit dhe Efiçencës së Energjisë (SMMAEE) që funksionon në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Stafi i SMMAEE, përbëhet prej gjithsejtë **8 punonjësve**, por nuk kanë specifikuar më tutje të dhënat mbi fushat e punës që mbulojnë këta zyrtarë.


Numri i angazhuar i shërbyesve civil nuk është i mjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore, dhe Komuna e Prishtinës nuk ka ofruar informata nëse ka pasur përmirësime në këtë aspekt gjatë vitit 2023..


Komuna e Prishtinës nuk ofruar informata nëse ka pasur përmirësime në vitin 2023 sa i përket trajnimeve për kornizën ligjore, dhe as për trajnimet e organizuara nga niveli qendror

Stafi komunal ka shfrytëzuar udhëzuesit profesional për planifikimin dhe menaxhimin e çështjeve mjedisore, por nuk janë dhënë detaje lidhur me këtë çështje.

Metodologjia e EC-it, merr në konsideratë **12 ligje** që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, të cekura më lartë.

Komuna e Prishtinës mbështetet në legjislacionin në fuqi por edhe në politikat që i ka hartuar për nevojat e veta, si:

 Në lidhje me Cilësinë e Ajrit, Komuna e Prishtinës shfrytëzon Ligjin për cilësinë e ajrit dhe Planin Lokal të Veprimit për Cilësinë e Ajrit për Prishtinën 2023-2028, dhe

 Në lidhje me Menaxhim të Mbeturinave shfrytëzon Ligjin për mbeturina dhe Strategjinë për Mbeturina (Master Planin) së bashku me të gjitha udhëzimet që burojnë nga to.

 **Plani i Veprimit për Qytetin e Gjelbër**

 **Plani Komunal i Veprimit për Efiçencë të Energjisë**

 **Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban**

Zyrtarët e Komunës së Prishtinës më parë kanë theksuar se korniza ligjore mjedisore është pjesërisht e konsoliduar dhe se ka hapësirë për përmirësime.

3

Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit

Sa i përket këtyre dokumenteve strategjike për planifikim dhe menaxhim mjedisor Komuna e Prishtinës aktive ka Planin Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit, Planin Lokal të Veprimit për Qytet të Gjelbër, Planin Komunal për Menaxhim të Mbeturinave, Planin Komunal të Veprimit për Efiçencë të Energjisë, etj. Këto plane sipas zyrtarëve janë të harmonizuara me planet e nivelit qendror.

Komuna e Prishtinës gjatë vitit 2023 ka realizuar projekte të nivelit lokal për rregullimin, promovimin dhe mbrojtjen e mjedisit, përfshirë ndërtimin e parqeve publike, transformimin e ngrohjes qendrore, pastrimin e lumenjve, sikurse edhe eliminimin e deponive ilegale.

Gjithashtu ka bashkë organizuar ngjarjen Climathon Prishtina 2023, me qëllim që ndërmarrësit e rinj të ofrojnë zgjidhje inovative për sfidat me të cilat përballet Kryeqyteti, si:

- 1 **Cilësia e ajrit dhe ndotja;**
- 2 **Mbeturinat dhe ekonomia qarkore;**
- 3 **Lëvizshmëria urbane e qëndrueshme (mobiliteti);**
- 4 **Hapësirat e gjelbra dhe biodiversiteti;**
- 5 **Infrastruktura rezistente (eficienca e energjisë);**
- 6 **Ekoturizmi, dhe**
- 7 **Zhvillimi rural i qëndrueshëm.**

4

Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor

Komuna e Prishtinës nuk ka raportuar sa i përket inspektimit dhe hartimit të raporteve mbi zbatimin e kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit përgjatë vitit 2023. Sipas praktikës bazuar në legjislacion hartohet raporti drejtuar AMMK-së sa i përket zbatimit të Planit të Menaxhimit të Mbeturinave në baza vjetore.

Te gjendja e deponive të mbeturinave sipas zyrtarëve monitorohet, por vetëm e atyre deponive ilegale, pasi që deponi të licencuara nuk ka në territorin e Komunës së Prishtinës, ndërsa vlerësimi i tyre nuk realizohet.

Sa i përket monitorimit të gjendjes së zonave të mbrojtura dhe monitorimit të gjendjes së pyjeve, identifikimin e çrregullimeve mjedisore, tejkalimeve të eksploatimit të resurseve natyrore dhe tejkalimeve të kushteve të vendgjuetive nuk është marrë asnjë përgjigje për vitin 2023.

5

Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave

Komuna e Prishtinës në vitin 2023 nuk ka informuar nëse ka sistem të monitorimit të cilësisë së ajrit, derisa më parë ka njoftuar se monitorimi bëhet vetëm nga IHMK-së me anë të dy stacioneve aktive.

Komuna e Prishtinës nuk ka sistem të monitorimit të dheut, e as sistem të monitorimit të cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Ndërsa parashikimi dhe paralajmërimi i hershëm i vërshimeve dhe thatësirave, sipas zyrtarëve komunal bëhet nga niveli qendror.

Sa i përket sistemit të menaxhimit të të dhënave mjedisore zyrtarët kanë raportuar se Komuna e Prishtinës nuk ka të ndërtuar sistem të menaxhimit të të dhënave mjedisore. Duke shtuar më tutje edhe faktin se nuk ka kapacitete të nevojshme teknike e as njerëzore për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore.

6

Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike

Zyrtarët përgjegjës bashkëpunimin dhe koordinimin me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore e kanë vlerësuar shumë korrekte.

Ngjashëm është vlerësuar edhe bashkëpunimi dhe koordinimi me nivelin qendror sa i përket hartimit të strategjive mjedisore.

Sa i përket pjesëmarrjes publike gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor Komuna organizon dëgjime publike për secilin dokument që hartohet nga ana tyre. Pjesëmarrja e qytetarëve në këto dëgjime publike sipas zyrtarëve është në nivel të kënaqshëm.

7

Licencimi dhe lejet mjedisore

Në lidhje me licencat aktive dhe lejet mjedisore në Komunën e Prishtinës nuk është ofruar asnjë informacion për vitin 2023.



GJETJET E RAPORTIT KOMUNA E PEJËS

1

Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Në Komunën e Pejës organi përgjegjës për planifikim dhe menaxhim mjedisor është Sektori për Mbrojtje të Mjedisit (SMM) që funksionon në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit- DUMM.

Stafi i DUMM-së, përbëhet prej gjithsejtë **12 punonjësve**, prej të cilëve vetëm **1 zyrtar** është i angazhuar në Sektorin e Mbrojtjes së Mjedisit.

Numri i punonjësve në SMM nuk është i mjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore, derisa profilet e nevojshme profesionale për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore janë vlerësuar si mesatare dhe nuk ka pasur njoftim nëse gjatë vitit 2023 ka pasur përmirësim në këtë aspekt.

Gjatë vitit 2023 për punonjësit e këtij sektori nuk janë organizuar trajnime rreth kornizës ligjore. Kurse sa i përket trajnimeve rreth çështjeve mjedisore është theksuar se janë organizuar trajnimet me temën: “Si të bëhet menaxhimi i mbeturinave në qytetin tim” dhe “Kush janë faktorët kryesor në ndotjen e mjedisit”.

Udhëzimi Administrativ për Leje Mjedisore Komunale shfrytëzohet si udhëzues profesional bashkë me të gjitha udhëzimet tjera për planifikim mjedisor.

2 Korniza ligjore

Metodologjia e EC-it, merr në konsideratë **12 ligje** që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, të cekura më lartë.

Komuna e Pejës për vitin 2023 nuk ka njoftuar lidhur me ligjet që shfrytëzohen nga organet komunale për planifikim dhe menaxhim mjedisor, teksa në vitet e shkuara janë listuar këto ligje:

- 1 **Ligji për VNM dhe VSM (Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis) dhe (Vlerësimi Strategjik Mjedisor)**
- 2 **Ligji mbi Parkun Kombëtar BN (Bjeshkët e Nemuna)**
- 3 **Ligji i Planifikimit**
- 4 **Ligji i Ndërtimit**

Zyrtarët e Komunës së Pejës kanë shprehur bindjen se korniza ligjore mjedisore është pjesërisht e konsoliduar, ndërsa njohuritë e stafit përgjegjës rreth kornizës respektive ligjore i kanë vlerësuar me notën shumë mirë.

3

Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit

Në lidhje me planifikimin dhe menaxhimin mjedisor, Draft Plani Lokal për Veprim në Mjedis ka qenë në proces të hartimit dhe se procesi i konsultimit publik do të zhvillohet gjatë vitit 2024. Sa i përket Vlerësimit Strategjik Mjedisor është njoftuar se Komuna e Pejës ka të miratuar VSM vetëm për Planin Zhvillimor Komunal dhe për Hartën Zonale Komunale

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis punohet çdo vit në bazë të kërkesave të palëve nga Udhëzimi Administrativ për dhënien e Lejeve Mjedisore Komunale.

Si projekte kapitale për rregullimin, promovimin dhe mbrojtjen e mjedisit, Komuna e Pejës ka raportuar angazhimin në projektin e hartimit të Hartës Zonale Komunale, derisa ka vazhduar edhe me ndërtimin e kanaleve të ujërave atmosferike, duke synuar të përmirësojë menaxhimin e ujërave dhe të zvogëlojë ndikimin e fenomeneve të ndryshme atmosferike në mjedisin urban dhe rural. Si projekt tjetër është veçuar zgjerimi i shtegut të shëndetit, duke e lidhur atë me shëtitoren buzë Lumbardhit; ndërkohë që SMM në bashkëpunim me shoqërinë civile zbaton projektin për cilësinë e ajrit, në kuadër të cilit është hartuar edhe Plani i Veprimit Lokal për Cilësi të Ajrit, që vjen si obligim ligjor nga Ligji Nr.08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja.

Krahas kësaj, Komuna ka raportuar se pas vërshimeve të fuqishme të muajit qershor, rindërtimi ka nisur në lagjen “Asllan Qeshme”, derisa ka filluar edhe projektin për ndërtimin e Qendrës për trajtimin e qenve endacakë.

Gjatë vitit 2023 nga zyrtarët është raportuar se për mbrojtjen e mjedisit është hartuar Plani i Veprimit Lokal për Cilësi të Ajrit dhe se në proces është edhe Plani Lokal i Veprimit në Mjedis.

4

Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor

Komuna e Pejës ka njoftuar se bëhet inspektimi i zbatimit të kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit, por se nuk hartohen raporte përkatëse për këtë. Zyrtarët kanë bërë të ditur se në mënyrë sistematike monitorohet gjendja e deponive të mbeturinave dhe gjendja e zonave të mbrojtura, dhe se janë identifikuar çrregullime mjedisore, derisa gjendja e pyjeve, përfshirë edhe gjendja shëndetësore të tyre nuk është monitoruar.

Mos ndarja e mbeturinave që në burim është cilësuar si problem dhe si çrregullim që vije nga personat fizik dhe juridik.

Sa i përket inspektimeve mjedisore, Komuna e Pejës ka raportuar se përgjatë vitit 2023 ka pasur **3 inspektorë mjedisor**, që në bazë të përshkrimit të detyrave janë marrë me çështjet që ndërlidhen me: menaxhimin e mbeturinave, mbrojtjen akustike, shfrytëzimin e resurseve natyrore, ndotjen e ambientit nga djegiet, etj.

Kontrolle të rregullta

126

Numri i gjobave të shqiptuara

19

Vlera totale e gjobave të shqiptuara

8000 €

Numri i lëndëve të proceduara në Gjykata

- 2 Në Gjykatën Komerciale janë dërguar dy lëndë;
- 1 Lëndë për shfrytëzim të resurseve natyrore dhe
- 1 Lëndë për ndotje të mjedisit - djegie

Menaxhimi i mbeturinave

43 kontrolle 9 gjoba

Mbrojta e resurseve natyrore

15 kontrolle 7 gjoba

Ndotje akustike dhe ndotje e mjedisit

35 kontrolle 3 gjoba

5 Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave

Komuna e Pejës edhe në vitin 2023 nuk ka pasur sistem të monitorimit të cilësisë ajrit, përpos një stacioni mobil të vendosur nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës. Kurse mbikëqyrja sistematike e cilësisë së ajrit realizohet përmes ekranit monitorues nga projekti i lartë cekur dhe monitorohen ndotësit, si: NO₂, SO₂, CO, PM₁₀, PM_{2.5}, O₃. Komuna ka hartuar Planit Lokal të Veprimit në Cilësi të Ajrit dhe është në proces të miratimit të atij për Mjedis.

Komuna e Pejës as në vitin 2023 nuk ka ndërtuar sistem të menaxhimit të të dhënave mjedisore. Sa i përket kapaciteteve të nevojshme njerëzore për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore, sipas zyrtarëve komunalë, ka mungesë të resurseve humane.

6 Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike

Zyrtarët përgjegjës të Komunës së Pejës bashkëpunimin dhe koordinimin me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore e kanë vlerësuar si të mirë mirëpo që ende ka nevojë për përmirësime.

Kurse bashkëpunimin dhe koordinimin me nivelin qendror sa i përket hartimit të strategjive mjedisore e kanë vlerësuar si jo të kënaqshëm, derisa bashkëpunimin me organizatat joqeveritare sa i përket zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme e kanë vlerësuar në nivel shumë të mirë, duke theksuar eksperiencat e tyre në hulumtime dhe vlerësime gjatë hartimit të këtyre dokumenteve: Plani për Cilësi të Ajrit, Rregullore Komunale për Mjedis dhe Rregulloren për Mbrojtjen e Ajrit.

Zyrtarët kanë bërë të ditur se gjatë periudhës së hartimit të PZHK (Plani Zhvillimor Komunal), HZK (Harta Zonale Komunale), VSM (Vlerësimi Strategjik Mjedisor), por edhe planet lokale të veprimit për cilësi të ajrit dhe për mjedis kanë zhvilluar procese të konsultimit publik dhe përfshirjes së qytetarëve, por se pjesëmarrja e publikut në procese të tilla nuk është në nivel të kënaqshëm.

7 Licencimi dhe lejet mjedisore

Në lidhje me licencat aktive dhe lejet mjedisore në Komunën e Pejës nuk është ofruar asnjë informacion për vitin 2023.



GJETJET E RAPORTIT KOMUNA MITROVICË E JUGUT

1

Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Në Komunën e Mitrovicës së Jugut, organi përgjegjës për Planifikim dhe Menaxhim Mjedisor është Sektori i Mjedisit (SM) dhe Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Ambientit (SMMA) që funksionojnë në kuadër të Drejtorisë për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Pyjeve. **Dy zyrtarë** janë të angazhuar në Sektorin e Mjedisit dhe **dy** në Sektorin e Menaxhimit të Mbeturinave dhe Ambientit.

Numri i angazhuar i shërbyesve civil sipas deklaratave të zyrtarëve nuk është i mjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore dhe se kanë nevojë për të angazhuar më shumë staf. Sipas tyre shërbyesit civil në SM dhe SMMA kanë profilet e nevojshme profesionale për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore, ku nga shkalla 1 (aspak) deri në 5 (shkëlqyeshëm), kanë dhënë vlerësimin 5 për vitin 2023.

Zyrtarët kanë bërë të ditur se gjatë vitit 2023 për punonjësit e këtij sektori janë organizuar trajnime rreth kornizës ligjore, nga donatorët, IKAP dhe Asociacioni i Komunave të Kosovës. Sipas tyre edhe sa i përket çështjeve mjedisore trajnimet janë organizuar nga organizatat e sipërpërmendura.

Gjatë vitit 2023, zyrtarët e kësaj komune, nuk kanë shfrytëzuar ndonjë udhëzues profesional për planifikimin dhe menaxhimin e çështjeve mjedisore, dhe kryesisht janë bazuar në legjislacionin në fuqi dhe dokumentet strategjike.

2

Korniza ligjore

Metodologjia e EC-it, merr në konsideratë **12 ligje** që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, të cekura më lartë.

Komuna e Mitrovicës, përkatësisht SM ka raportuar se mbështetet në këto dokumente ligjore:

- 1 Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- 2 Ligji nr. 08/I-181 për Vlerësimin e ndikimit në mjedis
- 3 Ligji për Ndërtim Nr. 04/L-110
- 4 Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 03/L-106
- 5 Ligji nr. 04/I-147 për Ujërat e Kosovës
- 6 Ligji nr. 08/I-025 për Mbrojtjen e ajrit nga ndotja
- 7 Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233

Zyrtarët e Komunës së Mitrovicës Jugore kanë shprehur bindjen se korniza ligjore mjedisore është pjesërisht e konsoliduar, meqë sipas tyre komuna nuk është konsultuar mjaftueshëm në ligjet për fushën e mjedisit, pastaj se nuk merren parasysh sfidat dhe objektivat e komunave, e në njëjtën kohë nuk ofrohen trajnime të duhura për aktet ligjore dhe nënligjore, derisa komunat nuk mbështeten as për rritjen e kapaciteteve për zbatimin e legjislacionit të ri.

■ Ndërsa njohuritë e stafit të këtij sektori rreth kornizës respektive ligjore i kanë notuar me 3, nga 1/aspak deri 5/shkëlqyeshëm.

3

Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis është aktiv dhe në bazë të tij vit pas viti edhe raportohet në mënyrë vjetore zbatueshmëria e tij. Ngjashëm është edhe me Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave. Sipas zyrtarëve strategjitë mjedisore lokale me strategjitë qendrore janë mirë të harmonizuara pasi pas aprovimit në Kuvendin e Komunës shkojnë për miratim në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Komuna ka njoftuar se gjatë vitit 2023, janë realizuar këto projekte që ndërlidhen me aspektet mjedisore: Zgjerimi i shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave në zona periferike; pastrimi i deponive ilegale; pilotimi i ndarjes së mbeturinave në burim dhe ndërgjegjësimi i nxënësve për mjedis. Si të arritura janë cekur sigurimi i dy kamionëve të rinj për mbeturina nga donatorët në vlerë 400 mijë euro; shpërndarja e 2,000 shportave shtëpiake 120L të fituara në "Garën për Mjedis të Pastër" dhe largimin e shumë deponive ilegale, që konsiderohen si problem i madh i kësaj komune.

Ndërsa sa i përket masave të ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit, zyrtarët raportojnë se kanë marrë masa për mbrojtjen e mjedisit si eliminimi i deponive ilegale, pilotimi i ndarjes së mbeturinave në burim dhe fushata vetëdijesimi për mbrojtjen e mjedisit.

4

Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor

Komuna e Mitrovicës Jugore ka njoftuar se gjatë vitit 2023 nuk është realizuar inspektimi i zbatimit të kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit meqë Komuna nuk ka ende inspektor mjedisor. Në këtë drejtim gjatë vitit 2023 nuk janë hartuar as raporte të inspektimit të kornizës ligjore.

Sipas zyrtarëve raportet e monitorimit të zbatimit të strategjive mjedisore hartohen në kuadër të planeve të punës dhe raporteve të punës që përfshijnë zbatimin e masave nga planet përkatëse komunale.

Sa i përket monitorimit të gjendjes së zonave të mbrojtura është theksuar se ato nuk monitorohen në mungesë të stafit adekuat. Ndërsa monitorimi i gjendjes së pyjeve sipas zyrtarëve komunalë është bartur në përgjegjësi të nivelit qendror nga MBPZHR dhe APK dhe se komunat nuk kanë asnjë kompetencë më në këtë aspekt.

Sa i përket çrregullimeve mjedisore nga aktivitetet e personave fizik ose juridik, si rast zyrtarët kanë theksuar ndotjen e brigjeve të lumenjve, në të cilat raste janë shqiptuar gjoba për personat që kanë degraduar lumenjtë me mbeturina ndërtimore që janë hedhur me kamion.

Sa i përket inspektimeve mjedisore kjo komunë edhe pse nuk ka inspektor mjedisor për vitin 2023, sipas raportit vjetor, ka shqiptuar 5 gjoba mandatore për ndotjen e mjedisit sipas Udhëzimit Administrativ përkatës.

Më tutje, zyrtarët janë përgjigjur se në vazhdimësi janë dërguar lëndë në Gjykatën themelore në Mitrovicë për prerje ilegale dhe veprime ilegale me pyje. Ndërkaq theksohet se sa i përket kushteve të vendgjuetive nuk janë identifikuar tejkalime.

5 Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave

Komuna e Mitrovicës edhe gjatë vitit 2023 nuk ka pasur sistem të monitorimit të cilësisë ajrit, por mbikëqyrja sistematike e cilësisë së ajrit realizohet nga niveli qendror të cilët në këtë komunë kanë të vendosur një stacion.

Kjo komunë, po ashtu nuk ka sistem të monitorimit të dheut, e as sistem të monitorimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Ndërsa sa i përket parashikimit dhe paralajmërimit të hershëm të vërshimeve dhe thatësirave pranohen raporte e paralajmërime nga niveli qendror.

Zyrtarët kanë raportuar se në mungesë të stafit adekuat, pajisjeve të nevojshme e programeve, si dhe mungesës së trajnimeve nuk mund të funksionalizohet sistemi i menaxhimit të dhënave mjedisore.

6 Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike

Zyrtarët përgjegjës të Komunës së Mitrovicës, bashkëpunimin dhe koordinimin me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore dhe hartimit të strategjive mjedisore e kanë vlerësuar si aspak të kënaqshme duke theksuar se duhet të ketë më shumë përpjekje për rritjen e bashkëpunimit.

Sipas tyre edhe niveli i bashkëpunimit me organizatat joqeveritare sa i përket zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme, është në nivel pak të kënaqshëm, meqë rrallë herë pranojnë ftesa për aktivitete e punëtori. Sa i përket zhvillimit të proceseve me pjesëmarrje publike gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor kanë treguar se e zbatojnë në përputhje me ligjet në fuqi dhe se janë pak të kënaqur me pjesëmarrjen e qytetarëve në këto diskutime.

7 Licencimi dhe lejet mjedisore

Sipas të dhënave të paraqitura nga Komuna në vitin 2023 janë lëshuar gjithsejtë **12 leje mjedisore komunale**, dhe atë kryesisht për objekte të banimit, tregtare, afariste, etj.



GJETJET E RAPORTIT KOMUNA E GJILANIT

1

Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Në Komunën e Gjilanit organi përgjegjës për planifikim dhe menaxhim mjedisor është Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit. Në kuadër të kësaj drejtorie bazuar në raportet e viteve të shkuara nuk ka sektor sa i përket fushës së mjedisit, derisa në këtë drejtori është i angazhuar vetëm një zyrtar mjedisor. Komuna nuk ka raportuar nëse ka pasur përmirësime në këtë aspekt në vitin 2023.

Numri i angazhuar i shërbyesve civil në këtë drejtori nuk ka qenë i mjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore, dhe nuk ka njoftime nëse ka pasur përmirësime gjatë vitit 2023.

Sa i përket pyetjes se a kanë shërbyesit civil profilet e nevojshme profesionale për kryerjen e detyrave përgjigja ka qenë po dhe vlerësimi i përgatitjes profesionale ka qenë shumë mirë, derisa në vitin 2023 nuk është njoftuar nëse ka pasur përmirësime në këtë aspekt.

Zyrtarët komunalë kanë bërë të ditur se gjatë vitit 2023 për punonjësit e këtij sektori janë organizuar trajnime rreth kornizës ligjore dhe rreth çështjeve mjedisore, më saktësisht trajnimi për Ligjin për Mbeturina.

Punonjësit më parë nuk kanë shfrytëzuar ndonjë udhëzues profesional për planifikimin dhe menaxhimin e çështjeve mjedisore, por gjatë kryerjes së detyrave kryesisht janë fokusuar në legjislacionin në fuqi dhe dokumentet strategjike për të cilat janë të obliguar t'i zbatojnë. Nuk ka pas raportim për përmirësim eventual gjatë vitit 2023.

2

Korniza ligjore

Metodologjia e EC-it, merr në konsideratë **12 ligje** që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, të cekura më lartë.

Komuna e Gjilanit ka raportuar se mbështetet në këto dokumente ligjore:

- 1 **Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025**
- 2 **Ligji nr. 08/I-181 për Vlerësimin e ndikimit në mjedis**
- 3 **Ligji për Ndërtim Nr. 04/L-110**
- 4 **Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 03/L-106**
- 5 **Ligji nr. 04/I-147 për Ujërat e Kosovës**
- 6 **Ligji nr. 08/I-025 për Mbrojtjen e ajrit nga ndotja**
- 7 **Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233**
- 8 **Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233**
- 9 **Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233**

Ndërsa në kuadër të Udhëzimeve Administrative shfrytëzohen:

- 1 **U.A Nr.01/2017 për Dhënien e Lejes Mjedisore Komunale,**
- 2 **U.A Nr.14/2015 për Ndëshkim me Gjoba Mandatore,**
- 3 **U.A Nr.01/2020 për Menaxhimin e Mbeturinave që përmbajnë azbest,**
- 4 **U.A Nr. 06/2018 për Ndëshkimet me Gjoba Mandatore,**
- 5 **U.A Nr.03 /2018 për Procedurat për Leje Ujore,**
- 6 **U.A Nr. 07/2015 për Menaxhimin e Mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore.**

Nuk ka njoftim nëse është bërë ndonjë përditësim gjatë vitit 2023.

Zyrtarët kanë vlerësuar se korniza ligjore është e konsoliduar mirë dhe kanë vlerësuar me shkëlqyeshëm njohuritë e stafit rreth kornizës ligjore.

3

Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit

Në vitet paraprake ishte theksuar se si dokument për planifikim dhe menaxhim mjedisor, Komuna e Gjilanit ka hartuar Planin Lokal të Veprimit për Mjedis, i cili nuk ishte miratuar në Kuvendin e Komunës së Gjilanit. Nuk ka pasur njoftime nëse ka pasur përmirësime në këtë aspekt gjatë vitit 2023.

Sa i përket harmonizimit të strategjive lokale me strategjitë qendrore zyrtarët kanë pohuar se ato janë të harmonizuara meqë ato kanë kaluar filtrin e ligjshmërisë nga nivelit qendror. Ndërsa për projektet kapitale të nivelit lokal për rregullimin, promovimin dhe mbrojtjen e mjedisit zyrtarët kanë thënë se në mungesë të politikave publike adekuate nuk mund të hartohen projektet e tilla.

Sa i përket masave të ndërmarra nga ana e nivelit lokal për mbrojtjen e mjedisit, zyrtarët kanë thënë se në mungesë të sektorit mjedisor dhe të PLVM, komuna nuk ka marrë masa për mbrojtje të mjedisit, duke përjashtuar masat e paraparanga Plani Zhvillimor Komunal dhe planet tjera komunale.

4

Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor

Zyrtarët e Komunës së Gjilanit kanë njoftuar se Sektori i Inspektimeve për sferën e mjedisit përbëhet nga **4 inspektorë**, ku njëri është me kontratë të rregullt dhe 3 të tjerë me kontrata të përkohshme.

Sipas tyre inspektimi i kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit realizohet rregullisht, dhe se hartohen raporte të inspektimit të kornizës ligjore si p.sh.:

-Raporti për monitorimin e zbatimit të lejes mjedisore komunale për objektet e banimit kolektiv.

Zyrtarët e Komunës së Gjilanit kanë njoftuar se gjendja e deponive të mbeturinave inspektohet në mënyrë sistematike, njëjtë sikurse edhe gjendja e zonave të mbrojtura, ku raportimi bëhet para datës 31 mars në AMMK. Gjendja e pyjeve sipas këtyre zyrtarëve nuk është monitoruar gjatë vitit 2023 dhe nuk janë identifikuar çrregullime mjedisore nga aktivitetet e personave fizik dhe juridik. Ngjashëm nuk janë identifikuar raste të tejkalimit të eksploatimit të resurseve natyrore mbi kushtet e lejuara apo shkelje në menaxhimin e burimeve drusore dhe faunës së egër.

Gjatë vitit 2023, inspektorët mjedisor të kësaj komune kanë shqiptuar gjithsejtë **22 gjoba mandatore** për ndotje të mjedisit.

Komuna ka pranuar kërkesa verbale dhe zyrtare për probleme të ndryshme në aspektin e mjedisit (hedhja e mbeturinave, derdhja e çfarëdo materiali në hapësira publike, inspektim për ndotjen e lumenjve, ndotja akustike etj.) për të cilat pas inspektimit në terren ka lëshuar edhe aktet e nevojshme normative (përgjigje, vendime, gjoba, etj).

NR.	AKTIVITETI, MASAT E NDËRMARRA DHE NUMRI I TYRE	2023
1	Numri i inspektimeve	235
2	Numri i procesverbaleve të hartuara	172
3	Numri i gjobave të shqiptuara	22
4	Numri i kërkesave të dorëzuara në Gjykatë	01
5	Numri i kërkesave të pranuar	53
6	Numri i kërkesave në shqyrtim	02

5

Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave

Komuna e Gjilanit vjet ka raportuar se ekziston një stacion për monitorimin e cilësisë së ajrit i vendosur nga AMMK në oborrin e shkollës fillore “Selami Hallaqi”, dhe se nuk ka mbikëqyrje sistematike të cilësisë së ajrit nga ana komunës, por se kjo realizohet nga ana e Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës. Nuk ka njoftim nëse ka pasur përmirësime në këtë aspekt në vitin 2023.

Sa i përket sistemit të monitorimit dhe mbikëqyrjes sistematike të cilësisë së dheut dhe ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësorë vjet është raportuar se nuk realizohet, vetëm se për këtë të fundit (cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësorë) monitorimi realizohet nga Instituti i Shëndetit Publik dhe Kompania “Hidromorava” nga të cilët realizohet edhe analiza fiziko-kimike dhe mikrobiologjike të ujit. Nuk ka njoftim nëse ka pasur përmirësime në këtë aspekt në vitin 2023.

Edhe gjatë vitit 2023, Komuna e Gjilanit nuk ka pasur sistem të menaxhimit të dhënave mjedisore. Sa i përket posedimit të kapaciteteve të nevojshme teknike për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore kjo komunë nuk ka as staf e as kapacitete për grumbullimin dhe menaxhimin e tyre.

6

Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike

Zyrtarët përgjegjës të Komunës së Gjilanit bashkëpunimin dhe koordinimin me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore dhe hartimin e strategjive mjedisore e kanë vlerësuar si të kënaqshëm. Sipas tyre edhe niveli i bashkëpunimit me organizatat joqeveritare sa i përket zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme është po ashtu në nivel të kënaqshëm. Pjesëmarrja publike është vlerësuar si pak e kënaqshme gjatë konsultimit publik. Nuk ka njoftim nëse ka pasur përmirësime të ndjeshme në këtë aspekt në vitin 2023.

7

Licencimi dhe lejet mjedisore

Sa i përket lejeve mjedisore në kuadër të DUPMM zyrtarët kanë raportuar se janë lëshuar 32 vendime për dhënien e Lejes Mjedisore Komunale dhe se nuk ka licenca aktive për shfrytëzimin apo menaxhimin e resurseve mjedisore dhe shërbimeve të ndërlydhura.



GJETJET E RAPORTIT KOMUNA E FERIZAJIT

1

Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Në Komunën e Ferizajt organi përgjegjës për planifikim dhe menaxhim mjedisor është Sektori për Mbrojtjen e Mjedisit që funksionon në kuadër të Drejtorisë së Urbanizmit dhe e Mjedisit.

Stafi i Sektorit për Mbrojtje të Mjedisit ka qenë i pamjaftueshëm sepse në këtë sektor ka qenë i angazhuar vetëm **një zyrtar mjedisor**. Në vitin 2023 Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit ka raportuar se ka numër të kufizuar të punëtorëve në të gjitha sektorët.

Numri i angazhuar i shërbyesve civil sipas Komunës nuk është i mjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore. Por punonjësi në këtë dikaster ka profilin e nevojshëm profesional për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore.

Nuk ka pasur njoftime nëse gjatë vitit 2023 janë organizuar trajnime rreth kornizës ligjore për zyrtarët e kësaj komune nga niveli qendror, nga komuna apo ndonjë organizatë tjetër. Mirëpo, zyrtarët e kësaj komune gjatë vitit 2023 kanë marrë pjesë në trajnime të organizuara nga AKK dhe donatorët për menaxhimin e mbeturinave, të cilat trajnime janë mbajtur si brenda ashtu edhe jashtë vendit.

Ky dikaster shfrytëzon udhëzimet administrative të lëshuara nga niveli qendror:

- **Udhëzuesin Administrativ 1/2017 për dhënien e lejeve mjedisore komunale;**
- **Rregullore komunale Mbi Mbrojtjen e Mjedisit.**

2

Korniza ligjore

Metodologjia e EC-it, merr në konsideratë **12 ligje** që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, të cekura më lartë.

Komuna e Ferizajt, përkatësisht SMM ka raportuar se mbështetet në këto dokumente ligjore:

- 1 Ligjin për Mbrojtje të Mjedisit 03/L-025,
- 2 Ligjin për Vlerësim të Ndikimit në Mjedis 08/L-181
- 3 Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës 03/L-233
- 4 Ligjin për Ujërat e Kosovës 04/L-147
- 5 Ligjin për Mbeturina 04/L-060

Nuk ka njoftim nëse gjatë vitit 2023 ka pasur përditësime në këtë aspekt. Zyrtarët e Komunës së Ferizajt kanë shprehur bindjen se korniza ligjore mjedisore nuk është mirë e konsoliduar, pasi sipas tyre legjislacioni dhe aktet nënligjore duhet të plotësohen më shumë. Ndërsa sa i përket njohurive të stafit të këtij sektori rreth kornizës respektive ligjore i kanë notuar me **5**, nga 1/aspak deri 5/shkëlqyeshëm.

3

Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit

Rrjedha e ciklit të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor nuk shquhet për qasje të strukturuar dhe të organizuar. Hartimi i politikave mjedisore kërkon dinamizëm me qëllim që ato ti përgjigjen nevojave të kohës. Plani Lokal i Veprimit në Mjedis ka skaduar në vitin 2015 dhe nuk është rishikuar apo hartuar plani i ri, kurse është hartuar Plani për Menaxhimin e Mbeturinave Komunale 2023-2027. Po ashtu është theksuar se komuna ka miratuar Hartën Zonale Komunale por që nuk është miratuar nga MMPHI, derisa Plani Zhvillimor i komunës 2017-2025, është dokumenti kryesor planifikues i komunës që përcakton aspektet zhvillimore dhe të shfrytëzimit të hapësirës, ku përfshihet edhe shpallja e zonave të mbrojtura.

Sa i përket projekteve kapitale nuk ka njoftime se cilat prej tyre shërbejnë për rregullimin, promovimin dhe mbrojtjen e mjedisit.

Por në fushën e mjedisit, janë veçuar punimet për dy projektet e gjelbërta siç është zgjerimi i Parkut të Lirisë, duke dyfishuar hapësirën e saj për qytetarët si dhe rregullimin e Parkut në Kodrën e Sherretëve, sikurse edhe miniparqet sipas konceptit “pocket park” në Talinoc të Muhaxherëve, Tërrn, Koshare e Gaçkë. Gjelbërimeve në oborret shkollore i është kushtuar rëndësi dhe është bërë mirëmbajtja e hapësirave nëpër institucione publike, derisa me qëllim të eliminimit të vërshimeve është intervenuar në disa fshatra. Gjithashtu është bërë identifikimi dhe eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave të ndryshme.

Gjatë vitit 2023, Komuna e Ferizajt ka zhvilluar projekte mbështetëse për Kompaninë Rajonale të Menaxhimit të Mbeturinave duke i furnizuar me 160 kontejnerë mbitokësor dhe 500 kontejnerë shtëpiak 120L e të cilat janë shpërndarë në qytet dhe fshatra duke mundësuar kështu rritjen dhe zgjerimin e klientëve në sistemin e menaxhimit të mbeturinave.

Në bashkëpunim me donatorët ka përfunduar faza e parë e hartimit të Planit për menaxhimin e integruar ndërkomunal të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt.

Ndërsa sa i përket strategjive mjedisore lokale, ato janë të harmonizuara me strategjitë qendrore.

4

Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor

Komuna e Ferizajt ka raportuar se inspektimi i zbatimit të kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit dhe hartimi i raporteve përkatëse realizohet. Sipas zyrtarëve, inspektorët e komunës së Ferizajt vazhdimisht hartojnë raporte për inspektim të zbatimit të kornizës ligjore dhe në bazë të kërkesave hartojnë edhe raporte tjera, lidhur me angazhimet për mbrojtje të mjedisit si dhe për zbatimin e udhëzimit për ndëshkime me gjoba mandatore.

Gjatë periudhës kohore dymbëdhjetë mujore janë inspektuar numër i madh i bizneseve që i nënshtrohen Lejes Mjedisore Komunale. Krahas kësaj, janë shqiptuar 122 gjoba mandatore duke filluar nga 50 deri në 500 euro, gjoba këto për hedhje të mbeturinave, vajrave në hapësira të ndaluara, shpërndarje të broshurave (fletushkave) promocionale, ndotje të rrugëve etj., që kanë rënë ndesh me Ligjin Nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturina - Neni 49. Përveç gjobave janë dhënë edhe shumë vërejtje të mos hedhen mbeturina në hapësira të cilat është e ndaluar hedhja e tyre.

Gjithashtu gjatë inspektimit në terren janë hartuar 42 procesverbale për konstatim të gjendjes si dhe rekomandime për ecurinë e mëtutjeshme. Po ashtu janë realizuar 15 njoftime/rekomandime me shkrim për eliminim të deponive ilegale.

Janë realizuar inspektime të kohëpaskohshme së bashku me Inspektorët e MMPHI-së lidhur me Planin Operativ "Parandalimi dhe Ndalimi i Aktiviteteve të jashtëligjshme në Sektorin Minerar".

Gjendja e deponive të mbeturinave monitorohet, në bashkëpunim me Agjencionin për Mbrojtje të Mjedisit, derisa monitorohen edhe zonat e mbrojtura.

5 Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave

Komuna e Ferizajt as në vitin 2023 nuk ka pasur sistem të monitorimit të cilësisë ajrit, dhe as mbikëqyrje sistematike të cilësisë së ajrit.

Kjo komunë, po ashtu nuk ka pasur as sistem të monitorimit të dheut, kurse cilësinë e ujit në komunën e Ferizajt, e mbikëqyrin Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik në Ferizaj dhe kompania regjionale e ujit "Bifurkacioni", të cilët monitorojnë saktësisht lumin në Nerodime.

Sa i përket parashikimit dhe paralajmërimit të hershëm të vërshimeve dhe thatësirave, është bërë e ditur se nuk realizohet, por vetëm pranohen njoftimet nga niveli qendror.

Sipas zyrtarëve komunalë nuk ka kapacitete të nevojshme teknike e as njerëzore për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore, pasi që në Komunë siç është cekur më lartë ka mungesë të kapaciteteve njerëzore në sferën e mjedisit.

6 Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike

Zyrtarët përgjegjës të Komunës së Ferizajt bashkëpunimin dhe koordinimin me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore e kanë vlerësuar si jo të kënaqshëm. Mesatar është vlerësuar edhe bashkëpunimi dhe koordinimi me nivelin qendror sa i përket hartimit të strategjive mjedisore.

Sipas tyre niveli i bashkëpunimit me organizatat joqeveritare sa i përket zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme është në nivel mesatar, derisa është cekur po ashtu se sa i përket temave mjedisore bashkëpunim të vazhdueshëm kanë pasur me OJQ "EC Ma Ndryshe".

Komuna e Ferizajt ka zhvilluar proces me pjesëmarrje publike për PZhK (Plani Zhvillimor Komunal), PRRU (Plani Rregullues Urban), PZhu (Plani Zhvillimor urban) dhe HZK (Harta Zonale Komunale), dhe pjesëmarrja e publikut në procese të tilla vlerësohet si shumë e kënaqshme.

7 Licencimi dhe lejet mjedisore

Sipas të dhënave të paraqitura me leje mjedisore komunale janë pajisur 50 qytetarë të cilët kanë bërë kërkesë pranë Drejtorisë së Mjedisit dhe Urbanizmit, dhe nuk është lëshuar asnjë licencë për çështje mjedisore nga niveli lokal.



GJETJET E RAPORTIT KOMUNA E GJAKOVËS

1

Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Në Komunën e Gjakovës organi përgjegjës për planifikim dhe menaxhim mjedisor është Sektori për Mbrojtjen e Mjedisit që funksionon në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit. Stafi i DUMM-së, përbëhet prej gjithsejtë **15 punonjësve**, prej të cilëve **2 zyrtarë** janë të angazhuar në Sektorin për Mbrojtjen e Mjedisit.







Sipas zyrtarëve numri i angazhuar i shërbyesve civil është i pamjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore. Sipas tyre shërbyesit civil në SMM kanë profilet e nevojshme profesionale për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore.

Zyrtarët komunalë kanë bërë të ditur se për punonjësit e këtij sektori nuk janë organizuar trajnime rreth kornizës ligjore, as nga niveli qendror, e as nga komuna apo ndonjë organizatë tjetër. Ndërsa rrallë herë janë organizuar trajnime rreth çështjeve mjedisore për stafin e SMM, kryesisht nga organizatat e shoqërisë civile, donatorët dhe AKK .

Stafi i SMM gjatë vitit 2023 nuk ka shfrytëzuar ndonjë udhëzues profesional për planifikimin dhe menaxhimin e çështjeve mjedisore, por gjatë kryerjes së detyrave kryesisht është fokusuar në legjislacionin në fuqi dhe dokumentet strategjike.

Metodologjia e EC-it, merr në konsideratë **12 ligje** që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, të cekura më lartë.

Komuna e Gjakovës ka njoftuar se mbështetet në këto dokumente ligjore:

-  **Ligji për Mbrojtje të Mjedisit**
-  **Ligji i Ndërtimit**
-  **Ligji i Planifikimit**
-  **Ligji për VNM**
-  **Ligji për VSM**
-  **si dhe ligjet tjera sektoriale që i përkasin sferës mjedisore.**

Zyrtarët e Komunës së Gjakovës kanë shprehur bindjen se korniza ligjore mjedisore është e konsoliduar pjesërisht, ku sipas tyre ligjet kryesisht janë adoptuar apo përkthyer, pa u përshtatur me specifikat e Kosovës, derisa në raste të caktuara edhe krijojnë dualizma dhe ndërhyrje tek njëri-tjetri, duke krijuar edhe konfuzitet.

Ndërsa njohuritë e stafit të këtij sektori rreth kornizës respektive ligjore i kanë notuar me 5, nga shkalla 1/aspak deri 5/shkëlqyeshëm.

3

Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit

Komuna e Gjakovës ka njoftuar se ka hartuar dokumentet e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor që rezultojnë nga korniza ligjore, me ç' rast janë listuar dokumentet si Plani Zhvillimor Komunal dhe Harta Zonale Komunale. Ndërsa Plani Lokal i Veprimit në Mjedis (PLVM) 2018-2023 është cilësuar si dokument strategjik mjedisor komunal, ku janë paraqitur prioritetet mjedisore dhe lista e veprimeve për zgjidhjen e tyre, me synimin për të mbështetur zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal.

Sipas zyrtarëve të Komunës së Gjakovës strategjitë mjedisore lokale janë harmonizuar me ato qendrore, derisa planifikohen edhe projekte për rregullimin, promovimin apo mbrojtjen e mjedisit, ndërkohë që realizimi konkret i tyre zhvillohet nga Drejtoria e Infrastrukturës dhe ajo e Shërbimeve Publike.

Sa i përket masave për mbrojtjen e mjedisit është theksuar se parandalimi realizohet përmes kontrollit të dhënies së lejeve të ndërtimit, Lejeve Mjedisore Komunale, por edhe me projektet e drejtorive përkatëse.

4

Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor

Komuna e Gjakovës nuk ka njoftuar nëse gjatë vitit 2023 është realizuar inspektimi i zbatimit të kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit dhe nëse është bërë hartimi i raporteve përkatëse.

Të dhëna nuk janë ofruar as në pyetjet lidhur me monitorimin sistematik të gjendjes së deponive të mbeturinave, monitorimin e gjendjes së zonave të mbrojtura, apo lidhur me gjendjen e pyjeve.

Ndërkaq në Raportin Vjetor të Ekzekutivit për vitin 2023, Drejtoria për Inspektoriat ka theksuar se në kuadër të aktiviteteve të implementuara mes tjerash ka bërë inspektimin e personave fizik dhe juridik me qëllim të mbrojtjes së sipërfaqeve publike, inspektime me qëllim të mbrojtjes së sipërfaqeve publike nga shfrytëzuesit e pa autorizuar, mjedisit për sa i përket mbeturinave, mbikëqyrjen e bartjes dhe deponimit të mbeturinave, mbikëqyrjen e gjelbërimit, ndriçimit publik nga dëmtuesit potencial, lëshimin e urdhëresave ndaj personave fizik apo juridik për mënjanim të parregullsive, parandalimin e dëmtimit të sipërfaqeve publike nga personat fizik apo juridik, shqiptimi i gjobave, fillimin e procedurave kundërvajtëse dhe penale kur konstatohen shkelje të dispozitave të ligjeve dhe akteve tjera nën ligjore përkatëse, inkasimi i të hyrave nga shqiptimi i gjobave, por edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj dhe akte tjera nën ligjore në fuqi.

Sipas këtij raporti janë realizuar gjithsejtë 2900 inspektime, pastaj janë lëshuar 394 urdhëresa për eliminim të parregullsive, dhe se janë shqiptuar 123 gjoba (pa specifikime se për kundërvajtjet), ndërkohë që janë shqyrtuar 217 lëndë, kërkesa dhe ankesa të ndryshme.

Në raport është cekur si koment edhe mungesa e Inspektorëve të Mbrojtjes së Mjedisit dhe Ndërtimit.

5 Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave

Komuna e Gjakovës ka njoftuar se ekziston vetëm sistemi i monitorimit të cilësisë së ajrit, me një stacion kryesor në qendër të qytetit dhe 4 të vogla në institucione të ndryshme për ajrin ambiental, ndërkohë që nuk ka sistem të monitorimit të dheut dhe të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Ndërsa parashikimi dhe paralajmërimi i hershëm i vërshimeve dhe thatësirave, sipas zyrtarëve komunalë bëhet nga niveli qendror respektivisht AME.

Komuna nuk ka ndërtuar sistem të menaxhimit të dhënave mjedisore. Sipas zyrtarëve komunalë, organet komunale nuk kanë kapacitete të nevojshme teknike e as njerëzore për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore, dhe se krahas mungesës së stafit edhe kompetencat janë të centralizuara.

6 Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike

Zyrtarët përgjegjës të Komunës së Gjakovës bashkëpunimin dhe koordinimin me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore e kanë vlerësuar si të pak të kënaqshëm, sikurse edhe për hartimin e strategjive mjedisore. Ndërsa në nivel mesatar është vlerësuar bashkëpunimi dhe koordinimi me shoqërinë civile sa i përket hartimit të strategjive mjedisore. Komuna e Gjakovës ka njoftuar se gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor proceset janë zhvilluar me pjesëmarrje publike, konform procedurave që i parasheh legjislativi në fuqi.

7 Licencimi dhe lejet mjedisore

Sipas të dhënave të paraqitura nga Komuna në raportin vjetor të Ekzekutivit në vitin 2023 janë lëshuar gjithsejtë **45 leje mjedisore komunale**, derisa është theksuar se komuna nuk ka kompetenca sa i përket licencave.



GJETJET E RAPORTIT KOMUNA E RAHOVECIT

1

Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Në Komunën e Rahovecit organi përgjegjës për planifikim dhe menaxhim mjedisor është Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit. Stafi i DUPMM-së, përbëhet prej gjithsejtë **4 punonjësve**, prej të cilëve **1 zyrtarë** është e angazhuar në Sektorin për Mbrojtjen e Mjedisit.

Sipas zyrtarëve numri i angazhuar i shërbyesve civil është i pamjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore. Sipas tyre shërbyesit civil nuk i kanë profilet e nevojshme profesionale për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore, respektivisht nivel mesatar.

Zyrtarët komunalë kanë bërë të ditur se për punonjësit e këtij sektori nuk janë organizuar trajnime rreth kornizës ligjore, as nga niveli qendror, e as nga komuna apo ndonjë organizatë tjetër. Ndërsa janë organizuar trajnime me disa indikatorë mjedisor për stafin, kryesisht nga organizatat e shoqërisë civile dhe donatorët, dhe atë kryesisht për planifikim, ngritje kapacitetesh dhe menaxhim të mbeturinave.

Stafi gjatë kryerjes së detyrave kryesisht është fokusuar në legjislacionin në fuqi dhe dokumentet strategjike, dhe UA për leje mjedisore komunale 01/2017.

2

Korniza ligjore

Metodologjia e EC-it, merr në konsideratë **12 ligje** që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, të cekura më lartë.

Komuna e Rahovecit nuk ka listuar se në cilat dokumente ligjore mbështet veprimtarinë në aspektin mjedisor.

Zyrtarët e Komunës së Rahovecit kanë shprehur bindjen se korniza ligjore mjedisore është e konsoliduar pjesërisht, ku sipas tyre ka mungesë kompetencash e buxheti, si dhe përkrahje të ulët nga ministritë përkatëse.

Ndërsa njohuritë e stafit të këtij sektori rreth kornizës respektive ligjore i kanë notuar me **4**, nga shkalla 1/aspak deri 5/shkëlqyeshëm.

3

Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit

Komuna e Rahovecit ka njoftuar se ka hartuar dokumentet e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor që rezultojnë nga korniza ligjore, me ç'rast janë listuar dokumentet si:

- 1 **Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2019-2024**
- 2 **Plani Lokal i Veprimit për Mbeturina 2022-2027**
- 3 **Plani i Mobilitetit Urban 2022-2027**
- 4 **Plani Lokal i Biodiversitetit 2024-2029**
- 5 **Plani Lokal i Cilësisë së Ajrit 2024-2029**

Sipas zyrtarëve aty janë paraqitur prioritetet mjedisore dhe lista e veprimeve për zgjidhjen e tyre, me synimin për të mbështetur zgjidhjen e problemeve mjedisore në nivel lokal.

Sipas zyrtarëve të Komunës së Rahovecit strategjitë mjedisore lokale nuk janë harmonizuar me ato qendrore, derisa planifikohen e realizohen edhe projekte për rregullimin, promovimin apo mbrojtjen e mjedisit, sikurse eliminimi i deponive ilegale, rregullimi i hapësirave të gjelbra, rregullimi i parqeve, etj.

Sa i përket masave për mbrojtjen e mjedisit është theksuar se parandalimi realizohet përmes inspektorit mjedisor.

4

Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor

Komuna e Rahovecit ka **1 inspektor mjedisor** që vepron në kuadër të Drejtorisë së Inspektorateve, dhe është vlerësuar se ky numër është i pamjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore.

Sipas zyrtarëve komunal inspektimi i zbatimit të kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit bëhet në baza të rregullta, dhe nga Inspektori i Mjedisit, hartohen raporte ditore, javore, mujore dhe vjetore për zbatimin e kornizës ligjore si dhe ndërrmarrjen e të gjitha aktiviteteve nga ana e inspektorit në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit.

Gjendja e deponive të mbeturinave monitorohet në mënyrë sistematike, derisa nga inspektori i mjedisit bëhet edhe monitorimi i zonave të mbrojtura në territorin e Komunës së Rahovecit.

Monitorimin e gjendjes së pyjeve e bën Agjencioni Pyjor i Kosovës, meqë nuk është në kompetencën e inspektorit komunal të mjedisit.

Zyrtarët komunalë kanë pohuar se janë identifikuar çrregullime mjedisore ku materiet ndotëse i tejkalojnë normat e përcaktuara me ligj dhe në të gjitha rastet janë ndërmarrë masat ndëshkuese sipas legjislacionit në fuqi, ku bëhet fjalë për çrregullime mjedisore si: Ndotje e ambientit si pasojë e hedhjes së mbeturinave pa vend, krijim i deponive ilegale, etj. Gjatë vitit 2023 janë shqiptuar gjithsej **41 gjoba për ndotësit e mjedisit**.

Monitorimi i eksploatimit të resurseve natyrore mbi kushtet e lejuara është në kompetencën e KPMM si dhe MMPH, derisa monitorimin e shkeljeve në menaxhimin e burimeve drusore, jo drusore dhe faunës së egër e bën Agjencioni Pyjor i Kosovës. Identifikimi i tejkalimeve të kushteve të vendgjuetive bëhet nga Inspektorati i Gjuetisë në kuadër të MMPH.

5 Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave

Komuna e Rahovecit ka njoftuar se nuk ka sistem të monitorimit të cilësisë së ajrit, ndërkohë që nuk ka sistem të monitorimit të dheut dhe të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Ndërsa parashikimi dhe paralajmërimi i hershëm i vërshimeve dhe thatësirave, sipas zyrtarëve komunalë bëhet nga niveli qendror respektivisht AME.

Komuna nuk ka ndërtuar sistem të menaxhimit të të dhënave mjedisore. Sipas zyrtarëve komunalë, organet komunale kanë kapacitete të nevojshme teknike e njerëzore për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore.

6 Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike

Zyrtarët përgjegjës të Komunës së Rahovecit bashkëpunimin dhe koordinimin me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore e kanë vlerësuar si mesatar, derisa bashkëpunimin e koordinimin për hartimin e strategjive mjedisore e kanë vlerësuar si aspak të kënaqshme. Në nivel aspak të kënaqshëm është vlerësuar edhe bashkëpunimi dhe koordinimi me shoqërinë civile sa i përket hartimit të strategjive mjedisore. Komuna e Rahovecit ka njoftuar se gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor proceset janë zhvilluar me pjesëmarrje publike, konform procedurave që i parasheh legjislacioni në fuqi.

7 Licencimi dhe lejet mjedisore

Sipas të dhënave të paraqitura nga Komuna e Rahovecit në vitin 2023 janë lëshuar gjithsejtë **32 leje mjedisore komunale**.



GJETJET E RAPORTIT **KOMUNA E MALISHEVËS**

1

Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Në Komunën e Malishevës organi përgjegjës për planifikim dhe menaxhim mjedisor është Drejtoria e Shërbimeve Publike. Stafi i drejtorisë, përbëhet prej gjithsejtë **4 punonjësve**, prej të cilëve **1 zyrtar** është i angazhuar në Sektorin për Mbrojtjen e Mjedisit.

Sipas zyrtarëve numri i angazhuar i shërbyesve civil është i pamjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore. Sipas tyre shërbyesit civil i kanë profilet e nevojshme profesionale për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore, respektivisht nivel të mirë.

Zyrtarët komunalë kanë bërë të ditur se për punonjësit e këtij sektori janë organizuar trajnime rreth kornizës ligjore, nga AMMK, AKK, donatorët, etj. Ndërsa janë organizuar trajnime me disa indikatorë mjedisor për stafin, kryesisht nga MMPHI, AMMK, AKK, donatorët.

Zyrtarët gjatë kryerjes së detyrave kryesisht janë fokusuar në legjislacionin në fuqi dhe dokumentet strategjike, si dhe në rregulloret komunale përkatëse.

2

Korniza ligjore

Metodologjia e EC-it, merr në konsideratë **12 ligje** që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, të cekura më lartë.

Komuna e Malishevës nuk ka listuar se në cilat dokumente ligjore mbështet veprimtarinë në aspektin mjedisor.

Zyrtarët e Komunës së Malishevës nuk kanë dhënë ndonjë vlerësim nëse korniza ligjore mjedisore është e konsoliduar.

Vlerësim nuk ka pasur as për njohuritë e stafit të këtij sektori rreth kornizës respektive ligjore.

3

Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit

Komuna e Malishevës nuk ka njoftuar nëse ka hartuar dokumentet e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor që rezultojnë nga korniza ligjore. Gjithashtu nuk është bërë e ditur nëse kjo komunë ka Plan Lokal të Veprimit në Mjedis aktiv. Kësisoj as në vitin 2023 nuk është njoftuar për ndonjë përmirësim në këtë aspekt.

Kjo komunë ka të miratuar Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale Komunale.

Në lidhje me masat dhe projektet kapitale për rregullimin, promovimin dhe mbrojtjen e mjedisit nuk është ofruar ndonjë e dhënë, dhe në këtë drejtim nuk ka pasur përmirësim as në vitin 2023.

4

Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor

Komuna e Malishevës ka **1 inspektor mjedisor** që vepron në kuadër të Drejtorisë së Inspektorateve, dhe është vlerësuar se ky numër është i mjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore, dhe se ka profilin e nevojshëm profesional për kryerjen e detyrave.

Sipas zyrtarëve komunal inspektimi i zbatimit të kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit bëhet në baza të rregullta, dhe nga Inspektori i Mjedisit, ku hartohen raporte gjashtë mujore dhe vjetore për zbatimin e kornizës ligjore si dhe ndërmarrjen e të gjitha aktiviteteve nga ana e inspektorit në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit.

Gjendja e deponive të mbeturinave monitorohet në mënyrë sistematike, derisa nga inspektori i mjedisit bëhet edhe monitorimi i zonave të mbrojtura në territorin e Komunës së Rahovecit.

Monitorimi i gjendjes së pyjeve realizohet herë pas here.

Zyrtarët komunalë kanë pohuar se nuk janë identifikuar çrregullime mjedisore, e as raste të tejkalimit të eksploatimit të resurseve natyrore. Ngjashëm nuk janë identifikuar shkelje as në menaxhimin e burimeve drusore, jodrusore dhe faunës së egër, e as tejkalime të kushteve të vendgjuetive.

Sa i përket gjobave mandatore për ndotësit e mjedisit nuk ka të dhëna për vitin 2023.

5 Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave

Komuna e Malishevës ka njoftuar se nuk ka sistem të monitorimit të cilësisë së ajrit, ndërkohë që nuk ka sistem të monitorimit të dheut dhe të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Ndërsa parashikimi dhe paralajmërimi i hershëm i vërshimeve dhe thatësirave, sipas zyrtarëve komunalë bëhet nga niveli qendror respektivisht AME.

Komuna nuk ka ndërtuar sistem të menaxhimit të dhënave mjedisore. Sipas zyrtarëve komunalë, organet komunale nuk kanë kapacitete të nevojshme teknike e njerëzore për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore.

6 Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike

Zyrtarët përgjegjës të Komunës së Malishevës bashkëpunimin dhe koordinimin me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore e kanë vlerësuar si të mirë. Ngjashëm bashkëpunimin e koordinimin për hartimin e strategjive mjedisore e kanë vlerësuar si të mirë. Nuk ka pas vlerësime sa i përket bashkëpunimit dhe koordinimit me shoqërinë civile sa i përket hartimit të strategjive mjedisore. Komuna e Malishevës ka njoftuar se gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor proceset janë zhvilluar me pjesëmarrje publike, konform procedurave që i parasheh legjislacioni në fuqi.

7 Licencimi dhe lejet mjedisore

Në lidhje me licencat aktive dhe lejet mjedisore komunale të lëshuara gjatë vitit 2023 zyrtarët e komunës nuk kanë ofruar ndonjë informacion.



GJETJET E RAPORTIT **KOMUNA E SUHAREKËS**

1

Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Në Komunën e Suharekës organi përgjegjës për planifikim dhe menaxhim mjedisor ka qenë Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mjedis dhe Emergjencë, në kuadër të cilës ka qenë edhe Sektori për Mjedis, me c'rast zyrtari për mbrojtje të mjedisit deri në gusht të vitit 2023 ka kryer aktivitetet e parapara në kuadër të kësaj drejtorie. Ndërsa nga gushti i vitit 2023, Sektori i Mjedisit ka kaluar te Drejtoria e Urbanizmit.

Sipas zyrtarëve numri i angazhuar i shërbyesve civil është i pamjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore. Sipas tyre shërbyesit civil i kanë profilet e nevojshme profesionale për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore, respektivisht nivel të mirë.

Zyrtarët komunalë nuk kanë njoftuar nëse për punonjësit e këtij sektori janë organizuar trajnime rreth kornizës ligjore, derisa për inspektorët mjedisorë nuk ka pas trajnime të veçanta.

Zyrtarët gjatë kryerjes së detyrave kryesisht janë fokusuar në legjislacionin në fuqi dhe dokumentet strategjike, si dhe në rregulloret komunale përkatëse.

2

Korniza ligjore

Metodologjia e EC-it, merr në konsideratë **12 ligje** që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, të cekura më lartë.

Komuna e Suharekës nuk ka listuar se në cilat dokumente ligjore mbështet veprimtarinë në aspektin mjedisor.

Komuna e Suharekës ka dërguar rregulloren komunale për menaxhimin e mbeturinave (PP4), por e njëjta nuk ka kaluar në asamblenë komunale.

Zyrtarët e Komunës së Suharekës nuk kanë dhënë ndonjë vlerësim nëse korniza ligjore mjedisore është e konsoliduar.

Vlerësim nuk ka pasur as për njohuritë e stafit të këtij sektori rreth kornizës respektive ligjore.

3

Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit

Komuna e Suharekës nuk ka njoftuar nëse ka hartuar dokumentet e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor që rezultojnë nga korniza ligjore. Gjithashtu nuk është bërë e ditur nëse kjo komunë ka Plan Lokal të Veprimit në Mjedis në fuqi.

Kjo komunë ka të miratuar Planin Zhvillimor Komunal dhe Hartën Zonale Komunale, që janë në implementim e sipër. Me MMPHI është realizuar bashkëpunimi në projektin: "Hartat e rrezikut nga përmbytjet dhe hartat e rrezikut nga vërshimet për të gjitha pellgjet e lumenjve në Kosovë".

Hartimi i Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm zbatohet në kuadër të projektit "Fuqizimi i Veprimit Lokal për Klimën", projekt i zbatuar në partneritet me UNDP në Kosovë.

Bashkëpunimi në mes Komunës së Suharekës dhe JICA ka vazhduar në "Projekti për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave drejt një shoqërie të shëndosh-Faza e dytë". Në kuadër të trajnimit për menaxhimin e mbeturinave është realizuar vizita studimore në Japoni për tu njohur se si funksionon grumbullimi, transporti, ndarja, riciklimi, djegia e deri te shndërrimi i tyre në energji elektrike si dhe vizitë në katër impiante në qytete të ndryshme të Japonisë.

Në kuadër të masave për mbrojtjen e mjedisit është bërë eliminimi i deponive ilegale në Komunë, ku janë pastruar 26 deponi, dje janë ndërmarrë aksione të rregullta pastrimi, sikurse edhe investime në hapësirat e gjelbra publike.

4

Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor

Komuna e Suharekës ka **3 inspektorë mjedisor** që veprojnë në kuadër të Drejtorisë së Inspektorateve, dhe është vlerësuar se ky numër është i mjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore, ku mes tjerash përfshihet mbikëqyrja e mbrojtjes së mjedisit në aspektin e mbeturinave, kanalizimit, ujit, shërbimeve tjera publike, për parandalimin e ndotjes dhe dëmtimin e mjedisit, sikurse edhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të cilat shkaktojnë çrregullime të përgjithshme në mjedis, materiet e rrezikshme dhe zonat e mbrojtura në natyrë duke identifikuar palën përgjegjëse.

Sipas zyrtarëve komunal inspektimi i zbatimit të kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit bëhet në baza të rregullta, dhe nga Inspektorët e Mjedisit hartohen raporte për zbatimin e kornizës ligjore si dhe ndërmarrjen e të gjitha aktiviteteve nga ana e inspektorit në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit.

Gjatë vitit 2023 nga Inspektorët e Mjedisit janë zhvilluar këto procedura:

Procesverbale
42
Kontrollime inspektuese
200
Urdhëresa për sanim të gjendjes
136
Aktvendime
34
Gjoba mandatore
14
Nga vetë palët janë kryer
44
Vizita në terren nga kërkesa e palëve
101

Sipas Drejtorisë së Bujqësisë janë identifikuar dhe janë marrë masa ligjore nga sektori i pylltarisë, ku rojet e pyjeve kanë ngritur fletëparaqitje si kundërvajtje ashtu edhe penale për dëmtuesit ilegal dhe uzurpatorët e pyjeve.

5 Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave

Komuna e Suharekës nuk ka njoftuar nëse ka sistem të monitorimit të cilësisë së ajrit, apo sistem të monitorimit të dheut dhe të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Ndërsa parashikimi dhe paralajmërimi i hershëm i vërshimeve dhe thatësirave, sipas zyrtarëve komunalë bëhet nga niveli qendror respektivisht AME.

Komuna nuk ka ndërtuar sistem të menaxhimit të dhënave mjedisore. Sipas zyrtarëve komunalë, organet komunale nuk kanë kapacitete të nevojshme teknike e njerëzore për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore.

6 Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike

Zyrtarët përgjegjës të Komunës së Suharekës nuk kanë dhënë vlerësime lidhur me bashkëpunimin dhe koordinimin me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore, apo për hartimin e strategjive mjedisore.

Nuk ka pas vlerësime sa i përket bashkëpunimit dhe koordinimit me shoqërinë civile sa i përket hartimit të strategjive mjedisore.

Komuna e Suharekës ka njoftuar segjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor proceset janë zhvilluar me pjesëmarrje publike, konform procedurave që i parasheh legjislacioni në fuqi.

7 Licencimi dhe lejet mjedisore

Në lidhje me licencat aktive dhe lejet mjedisore komunale të lëshuara gjatë vitit 2023 zyrtarët e komunës nuk kanë ofruar ndonjë informacion.



GJETJET E RAPORTIT KOMUNA E DRAGASHIT

1

Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Në Komunën e Dragashit organi përgjegjës për planifikim dhe menaxhim mjedisor është Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, zyrtarët e së cilës drejtori kanë raportuar se Sektori për Mbrojtjen e Ambientit nuk është funksional, pasi ende nuk është punësuar një zyrtar për mbrojtjen e mjedisit.

Nga Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike është raportuar se kanë të themeluar Sektorin (njësinë) e Menaxhimit të Mbeturinave dhe Mirëmbajtjes së Rrugëve, ku janë të angazhuar gjithsejtë **17 punonjës civil**. Nuk ka raporte për ndryshime në vitin 2023.

Teksa nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural është raportuar se kanë të themeluar Sektorin e Pylltarisë por nuk kanë raportuar sa i përket stafit/zyrtarëve të angazhuar. Nuk ka raporte për ndryshime në vitin 2023.

Numri i angazhuar i shërbyesve civil sipas deklaratave të DUKMM, DMSShShP dhe DPZhR nuk është i mjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore por nuk kanë dhënë përgjigje se a kanë shërbyesit civil në këto dikastere profilet e nevojshme profesionale për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore. Nuk ka njoftime për përmirësim në vitin 2023. Zyrtarët kanë bërë të ditur se gjatë vitit 2023 për punonjësit e këtij sektori janë organizuar trajnime të ndryshme nga AKK, JICA, etj.

2

Korniza ligjore

Metodologjia e EC-it, merr në konsideratë **12 ligje** që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, të cekura më lartë.

Komuna e Dragashit nuk ka ofruar informata lidhur me kornizën ligjore në të cilën bazohet sa i përket planifikimit dhe menaxhimit mjedisor dhe gjithashtu nuk ka vlerësuar nëse legjislacioni është i konsoliduar në lidhje me planifikimin dhe menaxhimin mjedisor. Në këtë aspekt nuk ka pasur përmirësim as gjatë vitit 2023.

3

Hartimi, harmonizimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit

Rrjedha e ciklit të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor nuk shquhet për qasje të strukturuar dhe të organizuar. Hartimi i politikave mjedisore kërkon dinamizëm me qëllim që ato ti përgjigjen nevojave të kohës. Komuna e Dragashit nuk ka raportuar se a kanë Plan Lokal të Veprimit në Mjedis në fuqi. Por nga zyrtarët është raportuar se kjo komunë ka të miratuar Planin Zhvillimor Komunal

Sa i përket masave dhe projekteve kapitale për rregullimin, promovimin dhe mbrojtjen e mjedisit nga ana e zyrtarëve në raportin vjetor të punës është theksuar se shtimi i hapësirave publike të gjelbra, hartimi i Rregullores komunale për menaxhimin e mbeturinave me përkrahjen e JICA-s dhe projekti për përmirësimin e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave, pastaj zbatimi i projektit për kullimin e ujit në lagunën ekzistuese, mbjellja e pishave rreth deponisë, identifikimi i deponive ilegale, etj.

Ndërsa sa i përket strategjive mjedisore lokale, Komuna ka bërë të ditur se janë të harmonizuara me strategjitë qendrore.

4

Mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor

Komuna e Dragashit ka njoftuar se nuk bëhet inspektimi i zbatimit të kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit, dhe se hartohen raporte të inspektimit të zbatimit të kornizës ligjore. Gjendja e deponive të mbeturinave dhe zonave të mbrojtura sipas zyrtarëve që kanë raportuar monitorohet vazhdimisht. Teksa nuk është raportuar sa i përket monitorimit çrregullimeve mjedisore, gjendjes së pyjeve, tejkalimeve të eksploatimit të resurseve natyrore apo të tejkalimit të kushteve të vendgjuetive.

5 Krijimi, grumbullimi, menaxhimi i të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të dhënave

Komuna e Dragashit nuk ka njoftuar nëse ka sistem të monitorimit të cilësisë së ajrit, apo sistem të monitorimit të dheut dhe të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Ndërsa parashikimi dhe paralajmërimi i hershëm i vërshimeve dhe thatësirave, sipas zyrtarëve komunalë bëhet nga niveli qendror respektivisht AME.

Komuna nuk ka ndërtuar sistem të menaxhimit të dhënave mjedisore. Sipas zyrtarëve komunalë, organet komunale nuk kanë kapacitete të nevojshme teknike e njerëzore për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore.

6 Bashkëpunimi, koordinimi dhe pjesëmarrja publike

Zyrtarët përgjegjës të Komunës së Dragashit nuk kanë dhënë vlerësime lidhur me bashkëpunimin dhe koordinimin me nivelin qendror në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore, apo për hartimin e strategjive mjedisore.

Nuk ka pas vlerësime sa i përket bashkëpunimit dhe koordinimit me shoqërinë civile sa i përket hartimit të strategjive mjedisore.

Komuna e Dragashit ka njoftuar se gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor proceset janë zhvilluar me pjesëmarrje publike, konform procedurave që i parasheh legjislacioni në fuqi.

7 Licencimi dhe lejet mjedisore

Në lidhje me licencat aktive dhe lejet mjedisore komunale të lëshuara gjatë vitit 2023 zyrtarët e komunës nuk kanë ofruar ndonjë informacion. Në raportin e punës për vitin 2023 figuron se janë lëshuar **2 leje mjedisore komunale**.



1

Skema institucionale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor

Komuna e Mamushës është treguar mjaft **jo transparente** sa i përket të dhënave për monitorimin mjedisor.

Të dhënat e vetme në këtë aspekt figurojnë në Planin Lokal të Veprimit në Mjedis që nuk është rishikuar, dhe në Planin Zhvillimor Komunal që ka pasur afat deri në fund të vitit 2023.

Në këto dy dokumente, situata e mjedisit paraqitet me mjaft sfida.

Te degradimi theksohet se shkaktar kryesor i degradimit është derdhja e mbeturinave. Zakonisht degradimi shkaktohet nga mbeturinat e hedhura në mënyrë ilegale në toka të zbrazëta dhe në lumenj.

Po ashtu prerja e drunjve është prezente në Mamushë, ku banorët kryesisht presin drunjtë për t'i shfrytëzuar për ngrohje si dhe për ndërtimin e serrave. Kjo shkatërron bukurinë e peizazhit dhe çon drejt shpyllëzimit.

Njëri nga shkaqet tjera të degradimit është përmbytja e lumit Toplluha, që ndodh në Shkurt – Mars. Kjo çon drejt shkatërrimit të shtratit të lumit që ka ndikim negative ndaj biodiversitetit në shtratin e lumit. Vërshimet gjithashtu bartin tokën e punueshme që çon drejt krijimit të tokës jopjellore.

Sipas këtyre dokumenteve ndotja në Mamushë shkaktohet kryesisht nga njerëzit. Shumica e ndotësve të ajrit janë ndotës sintetikë të cilët shkaktojnë ndotje mjedisore.

Në Mamushë nuk ka sistem monitorues për matjen e cilësisë së ajrit. Ajri ndotet nga llojet e lëndëve djegëse të përdorur nga banorët zakonisht për ngrohje gjatë stinës së dimrit. Shkaku tjetër i ndotjes së ajrit është trafiku.

Një nga faktorët më të rëndësishëm të ndotjes së dheut është rritja e popullsisë. Rritja e popullsisë rrit kërkesat dhe si rezultat rrit sasinë e mbeturinave. Cilësia e dheut ulet për shkak të kalbjes së mbetjeve të ngurta. Kjo mund të shihet shumë shpesh në Mamushë.

Në anën tjetër, një faktor tjetër që ndot dheun janë pesticidet dhe plehrat artificiale të përdorura në bujqësi. Përdorimi i tepërt i pesticideve dhe plehrave rrit sasinë e substancave toksike në dhe shkakton degjenerimin e strukturës së tij.

Në komunën e Mamushës, faktorët e ndotjes së ujit janë mbeturinat, ujërat e zeza, pesticidet dhe plehrat artificial.

Ndryshimi klimatik e prek edhe Kosovën, në këtë rast edhe Mamushën, dhe kjo mund të vërehet nga ngritjet e temperaturave, uljet e reshjeve, vërshimeve dhe thatësirave. Ndryshimi klimatik drejtpërdrejtë prek sektorët e zhvillimit dhe jetën e banorëve.

Zyrtarët komunalë nuk kanë ofruar të dhëna për treguesit e monitorimit të raportit e as nuk ka ndonjë raport lidhur me përmirësimet eventuale gjatë vitit 2023 në çështjet e sipërpërmendura.



PËRFUNDIME

Gjetjet e këtij raporti tregojnë se mjedisi dhe mbrojtja e tij ende nuk gëzojnë vëmendjen e duhur nga niveli komunal, pasi burimet njerëzore dhe financiare nuk janë në nivel të mjaftueshëm, gjë që mbase pastaj reflektohet edhe në gjendjen aktuale mjedisore.

Bazuar në monitorimin e vitit 2023, konkluzionet janë se shumica e komunave të monitoruara kanë krijuar organ përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit, ani pse kapacitetet njerëzore brenda këtij organi janë të pamjaftueshme si në aspektin kuantitativ ashtu edhe në atë profesional, ndërkohë që nuk ka pasur as aktivitete për fuqizimin e tyre në raport me kornizën aktuale ligjore. Trajnimet rreth çështjeve mjedisore për ta kanë qenë të rralla dhe në periudhën raportuese janë realizuar kryesisht në fushën e menaxhimit të mbeturinave.

Njohuritë e punonjësve komunalë rreth kornizës mjedisore nuk janë të nivelit më të lartë, derisa përcaktimi i sfidave me të cilat ata ballafaqohen si rrjedhojë e mangësive ligjore në fushën e mjedisit ka qenë i pamundur për shkak të mos listimit të tyre nga zyrtarët përkatës dhe në këtë aspekt nuk ka pasur ndonjë përmirësim as gjatë vitit 2023.

Shkalla e hartimit dhe zbatimit të politikave lokale për planifikimin dhe menaxhimin mjedisor mbetet problematik, për faktin se nuk ka organizim të mirëfilltë në këtë aspekt; përkatësisht, rrjedha aktuale e hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit aktualisht e bën të vështirë matjen e efikasitetit të këtyre veprimeve në përmirësimin e gjendjes mjedisore, ndërkohë që nuk është vërejtur ndonjë përmirësim i ndjeshëm gjatë vitit 2023, përjashtuar projektet që realizohen në baza vjetore nga komunat si kujdesi për hapësirat e gjelbra urbane, mbjellja e fidanëve, aksione të pastrimit të deponive ilegale dhe të tjera.

Inspektimi gjithashtu realizohet me burime të kufizuara njerëzore që pastaj vë në pikëpyetje edhe efikasitetin në parandalimin e dukurive negative në raport me mjedisin. Ndërkaq hartimi i raporteve përkatëse lidhur me zbatimin e kornizës ligjore të mbrojtjes së mjedisit dhe të zbatimit të strategjive mjedisore mbetet i paqartë edhe në vitin 2023 për shkak të mos shpalosjes së të dhënave të plota në këtë drejtim, ndërkohë që në tregues të caktuar nuk ka as monitorim nga zyrtarët komunal.

Komunat as gjatë vitit 2023 nuk kanë ndërtuar sistem të menaxhimit të dhënave mjedisore, për shkak të mungesës së resurseve teknike dhe njerëzore për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore.

Bashkëpunimi ndërinstytucional në hartimin e politikave publike vlerësohet të jetë i pamjaftueshëm. Ngjashëm edhe bashkëpunimi me shoqërinë civile përkundër disa iniciativave pozitive mbetet i pamjaftueshëm, ashtu sikurse edhe pjesëmarrja e publikut në hartimin strategjive lokale. Ndërsa sipas të dhënave të paraqitura nga komunat në vitin 2023 janë lëshuar leje mjedisore komunale, derisa nuk ka pasur të dhëna lidhur me lejet apo licencat tjera aktive.



REKOMANDIMET

- Të themelohen sektorët e mjedisit në komunat ku ato ende mungojnë
- Të shqyrtohen mundësitë për fuqizimin e sektorëve të mjedisit në komunat ku ato janë funksionale;
- Të shqyrtohen mundësitë për shtimin e punonjësve profesionistë në sektorët e mjedisit;
- Të organizohen trajnime për punonjësit mjedisorë rreth kornizës ligjore dhe rreth çështjeve mjedisore;
- Të përmirësohet dhe dinamizohet hartimi dhe zbatimi i dokumenteve të planifikimit dhe menaxhimit të mjedisit, projekteve dhe masave për mbrojtjen e mjedisit;
- Planet e nivelit lokal për menaxhimin mjedisor të përditësohen, bashkë me fuqizimin e raportimit të zbatimit të tyre;
- Të rriten kapacitetet njerëzore si dhe të shtohet mbikëqyrja inspektive dhe raportimi mjedisor;
- Të fillojë sa më shpejtë procesi i krijimit, grumbullimit, menaxhimit të të dhënave dhe sistemit të menaxhimit të të dhënave mjedisore;
- Të avancohet bashkëpunimi nivel qendror - lokal në hartimin e akteve ligjore dhe strategjive mjedisore;
- Të kultivohet bashkëpunimi më i afërt me organizatat e shoqërisë civile për të nxitur rritjen e pjesëmarrjes së publikut në çështjet mjedisore;
- Të rritet transparenca e komunave në raportimet për çështjet mjedisore;
- Mjedisi të vihet si prioritet gjatë hartimit të politikave publike nga komunat



PËR EC:

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikëqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të këtyre programeve: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse, Zhvillim i Qëndrueshëm dhe Mjedis e Ndryshime Klimatike. Ndërsa programi tjetër është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme:

- 1** Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale,
- 2** Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe
- 3** Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 - 2024) ka këto elemente:

- 1** Gjithëpërfshirjen
- 2** Qëndrueshmërinë
- 3** Dijen

EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithmbarshëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga poshtë lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

1 Paanshmëria

EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion.

2 Aktivizmi

Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës.

3 Orientimi drejt rezultateve

Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura.

4 Komuniteti bazë e veprimit

EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.